



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2020 – Numri: 151

Tiranë – E martë, 18 gusht 2020

PËRMBAJTJA

	Faqe
Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 652, datë 17.8.2020	Për dhënie ndihme financiare familjes së viktimës Samuel Nik Ndoj... 9513
Udhëzim i ministrit të Drejtësisë nr. 19, datë 5.8.2020	Për një ndryshim në udhëzimin nr. 4059/2, datë 7.6.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave”..... 9513
Udhëzim i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 21, datë 13.8.2020	Për përcaktimin e procedurave për administrimin e teksteve shkollore në përdorim falas në arsimin parauniversitar..... 9513
Urdhër i ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë nr. 264, datë 13.8.2020	Për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë..... 9517
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 124, datë 30.7.2020	Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a., për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”..... 9518
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 125, datë 30.7.2020	Mbi fillimin e procedurave për shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2020 dhe përditësimin e planit 5-vjeçar të shoqërisë OSSH sh.a.. 9520
Vendim i Entit Rregullator të Energjisë nr. 126, datë 30.7.2020	Mbi miratimin e “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”..... 9522

**VENDIM****Nr. 652, datë 17.8.2020****PËR DHËNIE NDIHME FINANCIARE
FAMILJES SË VIKTIMËS SAMUEL NIK
NDOJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, ligjit nr. 9936, datë 26.6.20008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 99/2018, “Për buxhetin e vitit 2019”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e ndihmës financiare, në shumën 500 000 (pesëqind mijë lekë), familjes së të miturit Samuel Nik Ndoj, të aksidentuar për vdekje gjatë operacionit humanitar të datës 15 gusht 2020, në afërsi të pikës së kalimit kufitar Kakavijë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1 të këtij vendimi, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit, miratuar për vitin 2020.

3. Ngarkohet ministri i Shtetit për Rindërtimin dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

UDHËZIM**Nr. 19, datë 5.8.2020****PËR NJË NDRYSHIM NË UDHËZIMIN
NR. 4059/2, DATË 7.6.2016 “PËR
ANONIMIZIMIN E TË DHËNAVE
PERSONALE NË VENDIMET
GJYQËSORE QË PUBLIKOHEN NË
PORTALIN ELEKTRONIK TË
GJYKATAVE”**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës, të pikës 2, të nenit 7, të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Pika 2, e nenit 6, të udhëzimit nr. 4059/2, datë 7.6.2016 “Për anonimizimin e të dhënave personale në vendimet gjyqësore që publikohen në portalin elektronik të gjykatave” të ndryshohet, si më poshtë vijon;

Emërtimi “Këshilli i Lartë i Drejtësisë” zëvendësohet me “Këshilli i Lartë Gjyqësor”.

2. Ky udhëzim hyn në fuqi menjëherë.

MINISTËR I DREJTËSISË
Etilda Gjonaj (Saliu)

UDHËZIM**Nr. 21, datë 13.8.2020****PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE
PËR ADMINISTRIMIN E TEKSTEVE
SHKOLLORE NË PËRDORIM FALAS NË
ARSIMIN PARAUNIVERSITAR**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 19 e 47, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe vendimit nr. 486, datë 17.6.2020, të Këshillit të Ministrave “Për shtypjen, botimin, shpërndarjen dhe shitjen e teksteve shkollorë të sistemit të arsimit parauniversitar”,

UDHËZOJ:**KREU I**
DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

1. Të gjithë nxënësit e arsimit bazë që marrin në përdorim falas tekstet shkollorë, në përputhje me përcaktimet në legjislacionin në fuqi, sipas katalogut të teksteve shkollorë, kanë detyrimin që këto tekste shkollorë t'i dorëzojnë në fund të vitit mësimor.

2. Tekstet shkollorë, të cilat janë pronë e institucioneve arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të përdoren për një periudhë kohore deri në tri vite shkollorë.

3. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe drejtoritë e shkollave publike janë strukturat përgjegjëse për



pajisjen me tekstet shkollore në përdorim falas të të gjithë nxënësve të ndjekin arsimin bazë në institucionet e tyre të varësisë dhe përfitojnë të gjitha tekstet shkollore në përdorim falas, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

4. Shpërndarja e teksteve shkollore të bëhet sipas planit të hartuar nga vetë shkolla, pas procedurës së vlerësimit të gjendjes fizike të teksteve shkollore të kthyera nga nxënësit. Nxënësit e çdo klase të pajisen në të njëjtin përpjesëtim me tekste shkollore të përdorura dhe tekste shkollore të reja.

5. Drejtorja e shkollës është e detyruar të krijojë dhe të ruajë regjistrin e nxënësve për tekstet e dhëna në përdorim falas, sipas klasave. Çdo lëvizje nxënësish pasqyrohet detyrimisht në këtë regjistrë. Ky regjistrë bën pjesë në dokumentacionin e shkollës. Për mbajtjen dhe përditësimin e tij mban përgjegjësi drejtori i shkollës.

6. Çdo mësues ngarkohet të porosisë nxënësit dhe t'i kontrollojë ata në vazhdimësi, që në tekstet shkollore ku shkruhet, të bëjnë shënime vetëm me laps, që mund të fshihet dhe nuk e bëjnë tekstin të papërdorshëm.

7. Numri i teksteve shkollore të vlerësuara si të përdorshme sipas këtij udhëzimi të jetë kriter vlerësimi, pjesë e performancës së institucionit arsimor (shkollës).

KREU II PROCEDURAT PËR DHËNIEN NË PËRDORIM FALAS TË TEKSTEVE SHKOLLORE

1. Drejtuesi i shkollës publike ngre Komisionin e Administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas, si strukturë që kryen të gjithë veprimtarinë e marrjes në dorëzim të teksteve shkollore, sipas porosisë së dhënë, kthimit dhe rishpërndarjes të nxënësit. Komisioni kryesohet nga drejtori i shkollës, ndërsa numri i anëtarëve përcaktohet në varësi të numrit të nxënësve që përfitojnë tekste në përdorim falas sipas legjislacionit në fuqi, por jo më pak se dy anëtarë.

2. Porosia të botuesi/distributori bëhet zyrtarisht nga drejtori i shkollës, pas procedurës zyrtare të përzgjedhjes nga titujt e katalogut dhe konfirmohet nga drejtuesi i institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar.

3. Botuesit/distributorët bëjnë furnizimin drejtpërdrejt në shkollë, sipas porosisë zyrtare të marrë. Furnizimi duhet të përfundojë detyrimisht 10 (dhjetë) ditë kalendarike para datës së fillimit të vitit shkollor.

4. Botuesi/distributori lidh kontratë me drejtuesin e institucionit arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar, për respektimin e afateve të furnizimit të shkollave me tekstet shkollore që do t'u jepen në përdorim falas nxënësve të arsimit bazë, që përfitojnë tekste në përdorim falas sipas legjislacionit në fuqi.

5. Drejtori i shkollës nënshkruan faturat tatimore të çdo furnizimi të bërë nga botuesit/distributorët, sipas sasisë së porositur. Originali i faturës tatimore, i nënshkruar nga drejtori i shkollës, dorëzohet në njësinë arsimore vendore për likuidimin financiar të subjektit furnizues, jo më vonë se 5 ditë kalendarike nga data e lëshimit të faturës. Drejtori i shkollës ruan fotokopje të çdo fature tatimore.

6. Drejtori i shkollës, brenda 15 ditësh kalendarike nga fillimi i vitit shkollor, njofton botuesin/distributorin për tekstet e pashpërndara (mbetur gjendje në shkollë), të cilat duhet t'i kthehen botuesit/distributorit në gjendjen fillestare. Për vlerën e teksteve të kthyera, plotësohet fatura përkatëse për kthimin e mallit, faturë që nënshkruhet nga drejtori i shkollës.

7. Drejtori i shkollës është përgjegjës për pajisjen në kohë me tekste shkollore të të gjithë nxënësve përfitues të regjistruar në atë shkollë. Komisioni i Administrimit të Teksteve Shkollore në përdorim falas i dorëzon me procesverbal tekstet shkollore, mësuesit kujdestar për çdo nxënës që përfiton tekste në përdorim falas sipas legjislacionit në fuqi.

8. Mësuesi kujdestar e pajis çdo nxënës me të gjitha tekstet shkollore njëherësh, sipas regjistrimit në klasën përkatëse, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë kalendarike përpara datës së fillimit të vitit shkollor.

9. Drejtori i shkollës organizon punën për mbajtjen e aktit të dorëzimit, sipas shtojcës 1 bashkëlidhur dhe pjesë përbërëse e këtij udhëzimi, për marrjen e teksteve shkollore nga nxënësit e çdo klase. Akti i dorëzimit hartohet në 2 (dy) kopje dhe nënshkruhet nga drejtori i shkollës, nga mësuesi kujdestar dhe nga njëri prej



prindërve apo përfaqësuesi që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit. Njëra nga kopjet e aktit të dorëzimit ruhet në drejtorinë e shkollës, ndërsa kopja tjetër dorëzohet në institucionin arsimor vendor, përgjegjës për arsimin parauniversitar përkatës.

KREU III ADMINISTRIMI I TEKSTEVE SHKOLLORE NË PËRDORIM FALAS

1. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të organizojnë punën që në çdo shkollë, në fund të vitit mësimor, të kryhet procesi i vlerësimit dhe i administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas.

2. Nxënësit dorëzojnë tekstet shkollore të marra në përdorim falas, sipas aktit të dorëzimit, menjëherë me përfundimin e vitit mësimor. Akti i dorëzimit të teksteve shkollore nënshkruhet nga drejtori i shkollës dhe nga mësuesi kujdestar. Mësuesi kujdestar bashkëpunon/koordinon me prindin e nxënësit apo personit që ushtron përgjegjësinë prindërore të nxënësit, për kthimin e teksteve nga nxënësit.

3. Komisioni i Administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas vlerëson gjendjen fizike të teksteve shkollore të përdorshme dhe identifikon nevojat për tekste shkollore të reja, për të cilat do të bëhet porositja sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi. Në regjistrin e krijuar nga çdo drejtori shkollor, të plotësohen shënimet përkatëse për çdo tekst shkollor.

4. Institucionet arsimore, brenda 10 ditësh nga përfundimi i procedurave, sipas pikave 2 dhe 3, të këtij kreu, të raportojnë në institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, numrin total të teksteve të papërdorshme për çdo titull. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të raportojnë në Drejtorinë Rajonale dhe në Drejtorinë e Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar.

5. Në rastet kur nevoja për tekste shkollore për vitin pasues tejkalon numrin e teksteve

shkollore të kthyer për t'u përdorur, shkolla do të bëjë porositë për tekstet shkollore shtesë, pasi të jetë siguruar nga institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, konfirmimi dhe auditimi i procedurës për çdo shkollë.

6. Tekstet shkollore të vlerësuara si të papërdorshme të administrohen dhe të ruhen në shkollë për efekt kontrolli dhe auditimi, sipas legjislacionit në fuqi, për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik. Drejtori i shkollës është përgjegjës për marrjen e masave dhe administrimin e këtij procesi, deri në riciklimin e teksteve shkollore të vlerësuara si të papërdorshme.

7. Institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar, të koordinojnë punën për administrimin e teksteve shkollore dhe për plotësimin e kërkesave për tekste shkollore shtesë për të gjitha shkollat në juridiksion të tyre.

KREU IV DISPOZITA TË FUNDIT

1. Udhëzimi nr. 24, datë 19.7.2018 “Për dhënien në përdorim falas dhe kthimin e teksteve shkollore për nxënësit e klasave I–IV të arsimit bazë” dhe udhëzimi nr. 9, datë 14.5.2019 “Për përcaktimin e procedurave të administrimit të teksteve shkollore në përdorim falas”, shfuqizohen.

2. Ngarkohet për zbatim të këtij udhëzimi Sekretari i Përgjithshëm, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave të Zhvillimit të Arsimit, në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, institucionet arsimore vendore, përgjegjëse për arsimin parauniversitar dhe institucionet arsimore të arsimit bazë.

Ky udhëzim hyn fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini



SHTOJCË 1

AKTDORËZIMI Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR_____ SHKOLLA_____					
Klasa _____ nxënësi _____ Prindi/përfaqësuesi ligjor _____ (emër, mbiemër, firma)					
Marrë në dorëzim nga nxënësi në fillim të vitit shkollor 20__–20__ tekstet:			Dorëzuar nga nxënësi në fund të vitit shkollor 20__–20__ tekstet:		
Nr.	Teksti	Gjendja	Nr.	Teksti	Gjendja
1			1		
2			2		
3			3		
4			4		
5			5		
6			6		
7			7		
8			8		
9			9		
10			10		
11			11		
12			12		
Data e marrjes në dorëzim nga nxënësi _____ Mësuesi kujdestar _____ Drejtori i shkollës _____ (emër, mbiemër, firma dhe vula)			Data e dorëzimit nga nxënësi _____ Mësuesi kujdestar _____ Drejtori i shkollës _____ (emër, mbiemër, firma dhe vula)		

**URDHËR****Nr. 264, datë 13.8.2020****PËR MBYLLJEN E VEPRIMTARISË SË
INSTITUCIONIT ARSIMOR JOPUBLIK
PARAUNIVERSITAR, KOPSHTI
“MEMORIAL”, TIRANË**

Në mbështetje të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të neneve 26 dhe 42, të ligjit nr. 69/2012, “Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë, hapur me urdhrin nr. 175, datë 16.6.2005, të ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor jopublik parauniversitar: -kopshti “Memorial”, në emër të shoqërisë “UFUK, Education & Publication Company” sh.p.k.

2. Institucioni arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë, ka për detyrë:

a) të kthejë pagesat e kryera nga nxënësit për pjesën e papërfunduar të shkollimit, si dhe çdo detyrim tjetër të papërmbytur, nëse ka;

b) të pajisë çdo nxënës me dokumentacionin e nevojshëm shkollor që do të shërbejë për transferimin e tij në një institucion tjetër të arsimit parauniversitar;

c) të vërë në dispozicion të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, çdo informacion të kërkuar deri në plotësimin dhe mbylljen e të gjitha kërkesave të parashikuara në këtë urdhër;

d) të mbulojë të gjitha shpenzimet për kryerjen e procedurave për transferimin e nxënësve, në zbatim të këtij urdhri;

e) të dorëzojë në Zyrën Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë, të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë e kryer;

3. Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, ka për detyrë:

a) të ngrejë grup pune brenda 3 (tri) ditëve nga hyrja në fuqi e këtij urdhri dhe të marrë masat për mbylljen e veprimtarisë së institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë;

b) të marrë masat për transferimin e nxënësve në institucione të tjera të arsimit parauniversitar për të gjithë nxënësit e regjistruar në këtë institucion arsimor;

c) të administrojë të gjithë dokumentacionin lidhur me veprimtarinë mësimore të kryer nga institucioni arsimor parauniversitar jopublik;

d) të ruajë në arkivin e institucionit dhe më tej të arkivojë sipas ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 “Për arkivat”, dokumentacionin e dorëzuar nga institucioni arsimor jopublik.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar dhe Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës të monitorojnë veprimtarinë e Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar, Tiranë për zbatimin e detyrave, sipas këtij urdhri.

5. Urdhri nr. 175, datë 16.6.2005, i ministrit të Arsimit dhe Shkencës “Për funksionimin e institucionit arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, shfuqizohet.

6. Ngarkohen për zbatimin e këtij urdhri, Sekretari i Përgjithshëm në Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme e Politikave dhe Zhvillimit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë, Drejtoria e Përgjithshme Rregullatore dhe Përpunshmërisë për Arsimin, Sportin dhe Rininë në MASR, Drejtoria e Përgjithshme e Arsimit Parauniversitar, Drejtoria Rajonale Arsimore Parauniversitare, Durrës, Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar, Tiranë, institucioni arsimor jopublik parauniversitar, kopshti “Memorial”, Tiranë dhe Shoqëria “Turgut Ozal Education” sh.a.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

**MINISTËR I ARSIMIT, SPORTIT
DHE RINISË
Besa Shahini**



VENDIM

Nr. 124, datë 30.7.2020

**MBI KËRKESËN E SHOQËRISË OST
SHA PËR DISA NDRYSHIME NË
VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR.
207, DATË 18.12.2017 “PËR MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR KRITERET
STANDARDE TË CILËSISË SË
SHËRBIMIT TË TRANSMETIMIT TË
ENERGJISË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 7, pika 1, nenit 16 dhe nenit 20 pika 1, germa “a”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; neneve 7, 8, 9 dhe 10 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017; nenit 104, pika 4, nenit 113, pikat 1 dhe 3, të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin, e përgatitur nga Drejtoria e Monitorimit të Tregut, “Mbi kërkesën e shoqërisë OST sh.a. për disa ndryshime në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 “Për miratimin e rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 207, datë 18.12.2017, ka miratuar “Rregulloren për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje, me kërkesë të shoqërisë OST sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, për shkak të nevojës së kryerjes së investimeve të domosdoshme, Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 270, datë 21.12.2018 dhe së fundmi me vendimin nr. 209, datë 16.12.2019, të Bordit të ERE-s “Për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017, “Për miratimin e rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, ka vendosur

për shtyrjen e afateve të plotësimit të kërkesave të kësaj rregulloreje, si më poshtë:

Pika 7.3 e “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OST sh.a. do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30 qershor 2020”.

- OST sh.a, me shkresën nr. 3577 prot., datë 16.6.2020, në bazë të nenit 10 të “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, ka parashtruar kërkesën për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019, duke kërkuar shtyrjen e afatit të pikës 7.3, të parashikuar në pikën 3, të vendimit nr. 209, datë 16.12.2019, nga data 30.6.2020 deri më datë 31.12.2021.

- OST sh.a. argumenton këtë kërkesë për shtyrje, duke bërë me dije se:

a) gjatë periudhës së operimit dhe mirëmbajtjes nga OST sh.a. të 76 nënstacione dhe rreth 170 trakte 110 kV, që janë marrë në dorëzim, ka rezultuar se gjendja teknike e këtyre pajisjeve rezulton edhe më problematike se sa ishte parashikuar në momentin e marrjes së tyre në dorëzim me gjithë përpjekjet ekstreme të OST sh.a. për mbajtjen e tyre në kushte optimale;

b) nisur nga topologjia e rrjetit të transmetimit, kryesisht të rrjetit 110 kV, konstatohet që një pjesë e konsiderueshme e përdoruesve të rinj të rrjetit të transmetimit, operojnë në linja të sistemit të transmetimit shumë të vjetra, të amortizuara, të cilat kanë kufizime në kapacitetet e tyre transmetuese në raport me kërkesat e këtyre përdoruesve.

- Në shkresën nr. 3577 prot., datë 16.6.2020. OST sh.a., ndër të tjera, parashtron se: “Një faktor tjetër shumë i rëndësishëm, është edhe vështirësia dhe kufizimet që krijoi shpallja e gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19”.

Konkluzione të ERE-s:

- OST sh.a. ka marrë nën administrim dhe pronësi traktet 110 kV të nënstacioneve 110/TM, që në vitin 2015, pra, me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar. Përgjatë kësaj periudhe gati 5-vjeçare OST sh.a., ka realizuar investime dhe ndërhyrje të konsiderueshme në rehabilitimin e rrjetit 110 kV;



- ERE, me vendim nr. 212, datë 28.12.2017, ka miratuar planin e investimeve për vitin 2017 dhe atë dhjetëvjeçar 2015–2025 të zhvillimit të rrjetit të transmetimit të shoqërisë OST sh.a.;

- Në kërkesën për shtyrje të afateve të parashikuara në rregullore, përcjellë nga OST sh.a. jepet një përshkrim i përgjithshëm i rrjetit 110 kV, në tërësi, dhe i trakteve 110 kV, në veçanti. Në këtë argumentim nuk bëhet një ndarje e saktë se sa investime janë realizuar në rrjetin 110 kV, sa trakte 110 kV kanë qenë të rehabilituara dhe sa trakte 110 kV janë rehabilituar nga OST sh.a., përgjatë viteve që këto trakte janë në administrim të OST sh.a.;

- Në parashtrimet e OST sh.a., nuk paraqitet asnjë problematikë për rrjetin transmetues kryesor atë 400 kV dhe 220 kV, element ky pozitiv për përmbushjen e standardeve të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike në sistemin e transmetimit, pasi çdo problematikë në këtë rrjet mund të çonte në një problematikë të shtuar në rrjetin 110 kV;

- Duke qenë se problematika në sistemin e transmetimit është e lokalizuar vetëm në rrjetin 110 kV, dhe në këtë rrjet kjo problematikë është e lokalizuar vetëm në elementet 110 kV, të cilët nuk janë të rehabilituar, rezulton se sistemi i transmetimit në tërësi paraqet një gjendje të qëndrueshme dhe me standarde teknike të mira;

- Ndërkohë OST sh.a. është ende në fazën e hartimit të planit të zhvillimit 10-vjeçar të rrjetit të transmetimit (TYNDP), i cili pritet të përfundojë në dhjetor të vitit 2020, duke identifikuar nyjat kritike të rrjetit, drejt të cilave do të orientohen edhe investimet e OST sh.a., me qëllim përmirësimin deri në zgjidhjen e problematikave të mësipërme të rrjetit të transmetimit;

- Bazuar në vlerësimet e mësipërme në aspektin teknik kërkesa e bërë nga OST sh.a. me shkresën nr. 3577 prot., datë 16.6.2020. OST sh.a. për ndryshimin e vendimit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019, nuk rezulton e argumentuar;

- Si rezultat i epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, nëpërmjet akteve normative të Këshillit të Ministrave në lidhje me përhapjen e COVID-19, si dhe VKM nr.243, datë 24.3.2020 “Për shpalljen e fatkeqësisë natyrore”, u vendosën kufizime në veprimtarinë dhe numrin e punonjësve në të gjitha ndërmarrjet shtetërore, si dhe mbyllja e një numri të konsiderueshëm aktivitetesh. Në këtë kontekst, kjo situatë e cila filloi në muajin mars

2020 deri në qershor 2020 ka pasur ndikimet e veta në mos realizimin e aktiviteteve të plota nga ndërmarrjet shtetërore përfshirë dhe OST sh.a.;

- Konstatohet se pamundësia e përmbushjes së detyrimit të parashikuar në pikën 7.3 të Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike të miratuar me vendimin e ERE-s nr. 207, datë 18.12.2017 (i ndryshuar me vendimin nr. 209, datë 16.12.2019), brenda afatit, vjen për shkaqe që nuk varen nga OST sh.a. dhe nuk mund të shmangen pavarësisht vullnetit, përpjekjeve apo kujdesit të arsyeshëm të OST sh.a.;

- Duke marrë parasysh situatën e krijuar nga COVID-19, si dhe nevojën e ERE-s për të realizuar komunikimet e nevojshme me Sekretariatit e Komunitetit të Energjisë, dhe rregullatorë të vendeve të tjera që përcaktojnë këto standarde për OST-të respektive, është e arsyeshme shtyrja e afatit të parashikuar në pikën 2, të vendimit nr. 209/2019, deri më 31.11.2020, me kushtin që brenda datës 30.12.2020, OST sh.a. të dërgojë në ERE “Treguesit e kriterëve standarde të performancës për Operatorin e Sistemit të Transmetimit”.

- Me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109/2019 është vendosur: pika 7.4 e “Rregullores për cilësinë e furnizimit dhe performancën e sigurisë së rrjetit në sistemin e transmetimit të energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “Brenda 6 muajve nga paraqitja e propozimit të OST sh.a., ERE do të vlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit”.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të pranojë pjesërisht kërkesën e OST sh.a. për shtyrjen deri në datën 31.12.2021, të afatit të parashikuar në pikën 2, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr. 207, datë 18.12.2019 “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”, si të paargumentuar e të mbështetur plotësisht në prova.

2. Të ndryshojë pikën 2, germa “a”, të vendimit të Bordit të ERE-s nr. 209, datë 16.12.2019 “Për një ndryshim në vendimin e Bordit të ERE-s nr.



207, datë 18.12.2019 “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”, si më poshtë:

a) Pika 7.3 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të transmetimit të energjisë elektrike”, ndryshon dhe bëhet: “OST sh.a. do të propozojë në ERE për miratim nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30.11.2020”.

3. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë OST sh.a. për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM
Nr. 125, datë 30.7.2020

**MBI FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR
SHQYRTIMIN E PLANIT TË
INVESTIMEVE PËR VITIN 2020 DHE
PËRDITËSIMIN E PLANIT 5-VJEÇAR
TË SHOQËRISË OSSH sh.a.**

Në mbështetje të nenit 16, dhe nenit 20, germa “e”, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të neneve 6, 7, 9, 10 dhe 11 të “Rregullores së procedurave të paraqitjes dhe miratimit të planit të investimeve nga operatorët e transmetimit dhe shpërndarjes së energjisë elektrike”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017, nenit 19, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 92/2 prot., datë 23.7.2020, të përgatitur nga grupi i punës, lidhur me “Fillimin e procedurave për shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2020 dhe përditësimin e planit 5-vjeçar të shoqërisë OSSH sh.a.”, Bordi i ERE-s,

konstatoi se:

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH sh.a.), me shkresën nr. 2424 prot., datë 18.2.2020, OSHEE sh.a. ka paraqitur kërkesën për shqyrtimin e “Planit të Investimeve për vitin 2020”, si dhe përditësimin e “Planit të zhvillimit të rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare 2020–2024”.

- Operatori i Sistemit të Shpërndarjes, nëpërmjet kësaj kërke, paraqet:

1. Hyrje (Përshkrimi i rrjetit).

2. Bilanci energjetik në rrjetin e OSSH-së për vitin 2019.

- Treguesit e humbjeve totale, teknike dhe joteknike.

- Humbjet totale të energjisë për 9-mujorin janar–shtator 2019.

3. Analiza e treguesve të performancës së rrjetit për periudhën tetor 2019.

4. SAIFI (*System Average Interruption Frequency Index*) koeficienti i ndërprerjes për klientë.

- Kohëzgjatja e përgjithshme e ndërprerjes për klient, në ndërprerjet e planifikuara dhe ndërprerjet e gjata të paplanifikuara.

- Realizimi i treguesve gjatë muajve të vitit 2019.

- Analiza e defekteve të shkaktuara në nyje të ndryshme të rrjetit.

- Përmirësimi në përqindje i treguesve sipas pajisjeve janar–shtator 2016–2019.

- Analiza e treguesve të performancës së rrjetit TM sipas zonave urbane, rurale dhe rurale të thellë për periudhën janar–shtator 2019.

- Analiza e treguesve të performancës së rrjetit shpërndarës sipas drejtorive rajonale.

- Analiza progresive e treguesve të performancës së rrjetit janar–shtator 2018–2019 dhe përmirësimi për periudhën janar–shtator krahasuar me vitin 2018.

5. Paraqitja e investimeve të realizuara për periudhën janar–shtator 2019.

6. Plan i investimeve të planifikuara për vitin 2020.

7. Mirëmbajtja.

Mirëmbajtja në rrjetin e shpërndarjes janar–shtator 2019.

Planin e Mirëmbajtjes për vitin 2020.

8. Impakti i investimeve për vitin 2020 në performancën e rrjetit.

9. Investimet në sisteme matje viti 2020.



10. Impakti në humbje i investimeve të reja në proces sipas prokurimeve dhe të tjerave për vitin 2020.

11. Impakti i investimeve në treguesit e performancës së rrjetit për vitin 2020.

12. Parashikimi i kërkesës për energji 2020–2024.

- Në dokumentacionin e përcjellë nga OSSH sh.a., si pika kritike janë evidentuar:

Humbjet teknike

- Rrjeti tejet i amortizuar, përfshirë moshën mesatare të nënstacioneve, mbi 40 vjet;

- Mirëmbajtje jo e plotë e nënstacioneve, amortizim i transformatorëve etj.;

- Investime të pamjaftueshme për përmirësimin e infrastrukturës së rrjetit të shpërndarjes;

- Mbingarkesa e elementeve të sistemit, si: transformatorë, fidera, përcjellës etj.;

- Kompensimi i pamjaftueshëm i energjisë reaktive;

- Mosrikonfigurimi i fiderave, i linjave dhe i transformatorëve të fuqisë, në mënyrë që të reduktohen gjatësitë e tyre;

- Përdorimi pa eficiencë i transformatorëve me fuqi të vogël.

Humbjet komerciale

- Ndërhyrjet e paligjshme në rrjet nga të cilat përfitohen sasi të mëdha dhe të vogla energjie;

- Eficiencë e ulët e matjes;

- Matës të palexuar;

- Leximi i matësve të cilët kanë gabim në matje të pavënë re;

- Faturim joeficient;

- Nënfaqurim;

- Shpërndarje e keqe e faturave të energjisë;

- Çështje ligjore të zvarritura;

- Mbledhje e pamjaftueshme e të ardhurave.

- Vizioni i OSSH-së për investimet që u kryen gjatë vitit 2019, ishte:

- Të realizonte ulje të humbjeve të energjisë elektrike (teknike dhe joteknike), e matur kjo me përqindjen e humbjeve.

- Të realizonte rritje të normës së arkëtimeve, e matur kjo me përqindjen e arkëtimeve për të gjithë energjinë e faturuar.

- Të kishte përmirësim të treguesve të cilësisë së furnizimit përmes futjes së treguesve të performancës.

- Nga shoqëria OSHEE sh.a., me miratim të Këshillit Mbikëqyrës gjatë vitit 2019, janë

ndryshuar e rialokuar fondet e investimeve disa herë për t'iu përshtatur gjendjes financiare të shoqërisë.

- OSHEE sh.a. ka kërkuar përditësimin e planit të zhvillimi të rrjetit për periudhën pesëvjeçare 2020–2024.

Informacioni i paraqitur nga shoqëria OSHEE sh.a., është analizuar, mbështetur në kërkesat e ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe vendimit të Bordit të ERE-s nr. 135, datë 6.9.2017 “Mbi rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”.

- Evidentohet se Plani i Investimeve nuk është paraqitur brenda afateve të përcaktuara në pikën 4, të nenit 75, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, dhe nuk janë përcjellë të gjitha informacionet sipas kërkesave të rregullores përkatëse, e më konkretisht:

- dokumentimi i konsultimit me palët e interesit,

- analiza kosto-përfitim në lidhje me planin e investimeve, ku çdo investim i parashikuar duhet të shoqërohet me relacione shpjeguese;

- shpjegime në lidhje me disa nga zërat e parashikuar në planin e investimeve për vitin 2020, të cilat shoqëria i ka evidentuar edhe në tabelën e parashikimit të Planit të Investimeve për vitin 2020 me fondet e vetë shoqërisë, si dhe me fondet e huajtura;

- Vlerësohet se parashikimet e shoqërisë të paraqitura në kërkesën për shqyrtimin e aplikimit të Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, për përcaktimin e tarifave sipas nivelit të tensionit për vitin 2020, për të cilën tashmë me vendimin nr. 2, datë 10.1.2020, Bordi i ERE-s ka nisur procedurë, nuk mund të merren për bazë për arsye se tashmë është mbyllur 6-mujori i parë i vitit 2020. Për atë kohë sa shoqëria nuk ka dërguar informacion mbi realizimin e treguesve financiarë dhe ekonomikë për këtë periudhë, nuk mund të përllogaritet mjaftueshmëria apo jo e të ardhurave të OSSH sh.a. në lidhje me mundësinë për realizimin e Planit të Investimeve për vitin 2020.

- OSHEE sh.a. do t'i kërkohej plotësimi dhe dërgimi i informacionit dhe të dhënave konform kërkesave të “Rregullores dhe procedurave të paraqitjes dhe miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar me vendimin nr.



135, datë 6.9.2017, të Bordit të ERE-s, për të vijuar më tej shqyrtimin e Planit të Investimeve për vitin 2020.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e planit të investimeve për vitin 2020 të shoqërisë OSSH sh.a.

2. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e përditësimit të Planit të Zhvillimit të Rrjetit të shpërndarjes për periudhën pesëvjeçare, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 182, datë 20.8.2018.

3. Shoqëria OSSH sh.a., të depozitojë në ERE, jo më vonë se 30 ditë nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, dokumentacionin e kërkuar sipas kushteve të parashikuara në “Rregulloren e procedurave të paraqitjes dhe miratimit të Planit të Investimeve nga Operatorët e Transmetimit dhe Shpërndarjes së Energjisë Elektrike”, miratuar nga ERE, me vendimin nr. 135, datë 6.9.2017.

4. Drejtoria Juridike dhe e Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve të njoftojë shoqërinë OSSH sh.a., lidhur me vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim, brenda 7 ditëve nga data e marrjes së vendimit në ERE dhe të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga botimi në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

VENDIM

Nr. 126, datë 30.7.2020

MBI MIRATIMIN E “RREGULLORES PËR SIGURINË KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE”

Në mbështetje të nenit 18, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, të ligjit nr. 2/2017, “Për sigurinë kibernetike”, VKM-së nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të

listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, si dhe të nenieve 15 dhe 26 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, 17.6.2016, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 30.7.2020, mbasi shqyrtoi relacionin nr. 92/3 prot., datë 23.7.2020, të përgatitur nga grupi i punës, mbi miratimin e “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike”,

konstatoi se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 235, datë 20.12.2019, vendosi mbi fillimin e procedurës për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

- Lidhur me këtë vendim të Bordit të ERE-s, me shkresën nr. 886, datë 31.12.2019, janë njoftuar Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Autoriteti i Konkurrencës, OSHEE sh.a., OST sh.a., KESH sh.a. dhe Sekretariati i Komunitetit të Energjisë Elektrike, dhe janë ftuar të japin komentet apo sugjerimet e tyre në lidhje me draftin për të cilin filloi procedura në ERE. Gjithashtu, me shkresën nr. 83/1, datë 21.1.2020, u njoftuan palët e interesit për organizimin e një seance dëgjimore me qëllim diskutimin mbi draftin e “Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

- Me shkresën nr. 758, datë 20.11.2019, ERE i ka propozuar “Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë”, duke bërë me dije “Autoritetin Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”, si dhe KESH sh.a., përditësimin e “Listës së infrastrukturave kritike të informacionit”, për të përfshirë në listën e këtyre infrastrukturave edhe infrastrukturat e kompanisë publike të prodhimit.

- Në vijim të sa më sipër, Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë me shkresën nr. 144/2, datë 28.4.2020, konfirmon në lidhje me marrjen e dëgjimit të fillimit të procedurës për miratimin e “Strategjisë për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”, si dhe informon se **OSHEE sh.a.** propozon që pjesë e infrastrukturës kritike të jenë:

- Sistemi i faturimit të OSHEE sh.a.;
- Sistemi i leximit të matësve (Mobiread);
- Sistemi financiar (SAP);



- Sistemi i monitorimit të nënstacioneve dhe kabinave (SCADA).

OST sh.a. propozon që pjesë e infrastrukturës kritike të jetë:

- Sistemi i monitorimit dhe komandimit (SCADA);

KESH sh.a. propozon që pjesë e infrastrukturës kritike të jenë:

- ABB Symphony SCADA system;

- Rrjeti i transmetimit të të dhënave (komunikimit) i KESH sh.a. (Tiranë – HEC Vau i Dejës, Tiranë – HEC Fierzë, Tiranë – HEC Koman);

- Draftstrategjia iu dërgua me email USAID-it dhe ACER-së (Agjencisë së Rregullatorëve Evropiane), si dhe iu janë kërkuar komente në lidhje me këtë “Draftstrategji për infrastrukturat kritike në sektorin e energjisë elektrike”.

- Në vijim, me shkresën nr. 935 prot., datë 26.6.2020, drafti i “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike” iu dërgua për komente dhe sugjerime edhe “Autoritetit Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike”.

- Duke qenë se pritet që AKCESK-ja, do të miratojë “Strategjinë kombëtare të sigurisë kibernetike 2020–2025”, e cila përfshin dhe operatorët e sistemit energjetik në vendin tonë, miratimi nga ERE i një strategjie të tillë do të sillte mbivendosje të dy strategjive dhe do të krijonte konfuzion se cila nga strategjitë e miratuara do të implementohet në sektorin e energjisë elektrike.

- ERE vlerëson se në zbatim të përcaktimeve ligjore duhet të miratojë rregulloren përkatëse për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike.

- Komentet dhe opinionet e palëve të interesuara dhe konsulentëve, janë marrë parasysh dhe janë reflektuar në rregullore duke bërë përshtatjen e nevojshme me aktet ligjore e nënligjore në fuqi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Miratimin e “Rregullores për sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike” (bashkëlidhur).

2. Drejtoria Juridike dhe Zgjidhjes së Mosmarrëveshjeve, të njoftojë palët e interesit për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohej rishikim brenda 7 ditëve kalendarike si dhe mund të bëhet ankimi në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti

RREGULLORE

PËR SIGURINË KIBERNETIKE TË INFRASTRUKTURAVE KRITIKE NË SEKTORIN E ENERGJISË ELEKTRIKE

Neni 1
Autoriteti

Enti Rregullator i Energjisë ka ndër objektivat e përcaktuar në nenin 18, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, promovimin dhe krijimin e një tregu të brendshëm konkurrues të sigurt dhe miqësor ndaj mjedisit për të gjithë klientët dhe furnizuesit, duke siguruar kushtet e duhura për funksionimin e sigurt dhe të qëndrueshëm të rrjeteve të energjisë elektrike, në bashkëpunim të ngushtë me Komunitetin e Energjisë dhe autoritetet rregullatore të vendeve të tjera. Neni 26, i ligjit nr. 43/2015, gjithashtu, përcakton se, sistemi i energjisë elektrike operon si një sistem i integruar me procese të vazhdueshme prodhimi, transmetimi, shpërndarjeje dhe konsumi të energjisë elektrike. Bazuar në sa më sipër, ERE konsideron sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë elektrike si element themelor për ruajtjen e sigurisë dhe integritetit të sistemit elektroenergjetik shqiptar.

Neni 2
Qëllimi

Qëllimi i kësaj rregulloreje është të përcaktojë rregullat dhe masat që duhet të ndërmerren nga subjektet e licencuara nga ERE në sektorin e energjisë elektrike, të cilët kanë përgjegjësi të garantojnë sigurinë kibernetike në infrastrukturat



kritike që zotërojnë dhe operojnë. Garantimi i sigurisë kibernetike në sistemin elektroenergjetik siguron furnizimin e pandërprerë me energji elektrike të konsumatorëve në vendin tonë.

Neni 3 Objekti

Kjo rregullore përcakton detyrimin e operatorëve që zotërojnë ose operojnë infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike për të vendosur dhe zbatuar masat e duhura gjatë projektimit, instalimit dhe funksionimit të rrjetit ose pajisjeve të përdorura prej tyre, në mënyrë që të garantojnë sigurinë, disponueshmërinë, integritetin dhe funksionimin e qëndrueshëm të sistemit elektroenergjetik. Operatorët duhet të paraqesin pranë ERE-s, sipas shtojcës nr. 2 dhe shtojcës nr. 3, raporte për çdo ndërhyrje të paplanifikuar, cenim ose incident në fushën e sigurisë, disponueshmërisë dhe integritetit të rrjeteve të tyre të komunikimit elektronik, si dhe çdo ndërhyrje, dëmtim që ka ndikim në funksionimin e rrjeteve dhe/ose të statusit të tyre të shërbimit.

Neni 4 Përcaktimi i termave

Termat e përdorur në këtë rregullore do të kenë kuptimin e mëposhtëm. Çdo term tjetër i përdorur në rregullore do të ketë kuptimin e përcaktuar në ligjin nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, ose në ligjin nr. 2 /2017 “Për sigurinë kibernetike”.

1. “CSIRT” – është ekipi i përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike.

2. “CSIRT sektorial” – është ekipi/ personi përgjegjës ndaj incidenteve të sigurisë kibernetike, në strukturën e një operatori që administron infrastruktura kritike dhe të rëndësishme të informacionit.

3. “Hapësirë kibernetike” – është mjedisi digjital i aftë të krijojë, të procesojë dhe të shkëmbejë informacionin e krijuar nga sistemet, shërbimet e shoqërisë së informacionit, si dhe rrjetet e komunikimit elektronik.

4. “Incident i sigurisë kibernetike” - është një ngjarje e sigurisë kibernetike, gjatë së cilës shkaktohet cenimi i sigurisë së shërbimeve ose

sistemeve të informacionit e të rrjeteve të komunikimit dhe sjell një efekt real negativ.

5. “Infrastrukturë kritike e informacionit” – është tërësia e rrjeteve dhe sistemeve të informacionit, cenimi apo shkatërrimi i të cilave do të kishte impakt serioz në shëndetin, sigurinë dhe/ose mirëqenien ekonomike të qytetarëve dhe/ose funksionimin efektiv të ekonomisë në Republikën e Shqipërisë.

6. “Operator i infrastrukturës kritike të informacionit” – është një person juridik, publik ose privat, që administron infrastrukturën kritike të informacionit dhe operon në sektorin e energjisë elektrike OST sh.a., OSHEE sh.a. dhe KESH sh.a..

7. “Rrezik i sigurisë kibernetike” – është një rrethanë ose një ngjarje, e identifikueshme në mënyrë të arsyeshme, e cila mund të shkaktojë cenimin e sigurisë së shërbimeve ose sistemeve të informacionit dhe të rrjeteve të komunikimit.

8. “Siguria e informacionit” – është sigurimi i konfidencialitetit, integritetit dhe disponueshmërisë së informacionit.

9. “Siguria kibernetike” - është tërësia e mjeteve ligjore, organizative, teknike dhe edukative, me qëllim mbrojtjen e hapësirës kibernetike.

10. “SKI” – janë sistemet e komunikimit dhe informacionit.

11. “AKCESK” – është Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike.

Neni 5 Rregulla të përgjithshme dhe parime bazë

1. Rregullorja për sigurinë kibernetike në infrastrukturën kritike në sektorin e energjisë elektrike është hartuar bazuar në nenin 18, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar, ligjit nr.2/2017 “Për sigurinë kibernetike” dhe VKM nr. 553, datë 15.7.2020, “Për miratimin e listës së infrastrukturave kritike të informacionit dhe të listës së infrastrukturave të rëndësishme të informacionit”, duke marrë parasysh që:

a) Qëllimi i ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar, është që përmes kuadrit teknik dhe ligjor të sigurohet furnizim i sigurt dhe i qëndrueshëm me energji elektrike i konsumatorëve, në përputhje me zhvillimet teknologjike. Ligji nr. 2/2017 “Për sigurinë



kibernetike” ka për qëllim arritjen e një niveli të lartë mbrojtjeje të sigurisë kibernetike dhe gatishmërinë ndaj sulmeve kibernetike, duke përcaktuar masat e sigurisë, të drejtat, detyrimet, si dhe bashkëpunimin e ndërsjellë ndërmjet operatorëve të infrastrukturave kritike përfshirë në sektorin energjetik, përmes të cilave sigurohen shërbimet e licencuara.

b) Operatori i infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike duhet të ndërmarrë masat e duhura proporcionale, me kosto efektive, teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë rrjetit për të menaxhuar, adresuar dhe trajtuar në mënyrën e duhur rreziqet që paraqiten për sigurinë e rrjeteve dhe të informacionit që ata menaxhojnë në përbushje të aktivitetëve të tyre dhe duke respektuar rolet e tyre.

2. Ndër të tjera kjo rregullore shërben si dokument mbështetës për operatorët e infrastrukturave kritike në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”. Për infrastrukturat kritike dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, si dhe vendos procese për të ndihmuar OIKI-në të demonstrojnë dhe të vërtetojnë se ata po menaxhojnë rreziqet e sigurisë kibernetike në lidhje me shërbimet e ofruara. Këto procese përfshijnë kryesisht:

a) Vetëvlerësimi nga OIKI-ja

OIKI-ja do të paraqesë vetëvlerësimin e tij në ERE bazuar në “Rregulloren mbi përmbytjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë (miratuar me urdhër nr. 22, datë 26.4.2018, të AKCESK-së). Ky vetëvlerësim do të përmbajë një informacioni të detajuar dhe të plotë (duke përfshirë metodologjinë që ka përdorur për të realizuar vetëvlerësimin, mënyrën se si e ka aplikuar këtë metodologji rezultatet e vetëvlerësimit të cilat duhet të përfshijnë identifikimin e riskut si dhe procesin e zvogëlimit të riskut) të çdo rreziku domethënës të identifikuar dhe çdo propozim fillestar për trajtimin e rrezikut përfshirë deklaram për rezultatin e nxjerrë duke identifikuar atë si “Jo e arritur” ose “Pjesërisht e arritur” dhe “e Arritur”.

Ky informacion duhet të dorëzohet duke përdorur modelin e raportimit të vetëvlerësimit, i cili gjendet në shtojcën. nr. 1.

Pasi të paraqitet informacioni në ERE, nëse ERE e gjykon të arsyeshme, mund të hyjë në vlerësime dhe të kërkojë informacione të mëtejshme për çështjet e raportuar për të realizuar vlerësimet

përkatëse. Kjo mund të përfshijë një kërkesë për sqarime të mëtejshme mbi rezultatet e vetëvlerësimit që konsiderohen si “Jo e arritur” ose “Pjesërisht e arritur”. Nëse informacioni që është dërguar në ERE është i paqartë ERE mund të kërkojë sqarime nga OIKI-ja.

OIKI-ja në çdo kohë mund të kërkojë që të konsultohet me ERE sa më shpejt të jetë e mundur nëse nuk është i sigurt për çështjet objekt raportimi. Pasi OIKI-ja të ketë përfunduar vetëvlerësimin e tyre, OIKI-ja duhet të marrin në konsideratë fushat për përmirësim.

Në vetëvlerësimin fillestar që do të realizohet nga OIKI-ja, qëllimi kryesor është kryerja e një vetëvlerësim objektiv dhe bazuar në rezultatet e vetëvlerësimit, OIKI-ja duhet të zhvillojnë një plan përmirësimi, atje ku ato janë të nevojshme ose sipas prioritetëve të përcaktuara nga ERE. Çdo vlerësim sipas statusit respektiv i arritur ose jo do të shoqërohet me shpjegimet përkatëse për çdo konkluzion. ERE mund të kërkojë që raportet e vetëvlerësimeve të përgatitura nga OIKI-ja të jenë të audituara.

b) Identifikimi dhe hartimi i planit të masave duke pasur parasysh rreziqet e mundëshme dhe të identifikuara

Pas procesit për paraqitjen e vetëvlerësimit të përcaktuar më lart, OIKI-ja duhet të propozojnë planet e tyre të masave tek autoritetet kompetente. OIKI-ja mund të kërkojë bashkëpunim me ERE siç përcaktohet më lart.

Planet e masave bazohen në vetëvlerësimet e OIKI-së duke identifikuar rreziqet në përputhje me procesin e tyre të menaxhimit të riskut dhe metodologjinë e riskut. Plani i përmirësimit duhet të përcaktojë planet e veprimit të sigurisë kibernetike që OIKI-ja synon të marrë atje ku rreziku është vlerësuar më i lartë duke konsideruar nivelet e tolerancës ndaj rrezikut. Planet e masave mund të përfshijnë ndër të tjera masat afatshkurtra ose masa strategjike afatgjata, për të cilat duhet të rivlerësohet buxheti i OIKI-së përmes planifikimit të duhur të biznesit. ERE, rast pas rasti, mund të kërkojë rishikimin e planit të masave nga OIKI-ja në mënyrë që t'i ndihmojë ata në prioritarizimin dhe planifikimin e mbrojtjes nga rreziku kibernetik.

c) Identifikimi dhe rishikimi i planeve të investimeve, të cilat duhet të marrin në konsideratë nevojën për të zvogëluar rreziqet e identifikuara në pikën (2.b)



OIKI-ja duhet të zhvillojë një sistem të menaxhimit të sigurisë së informacionit, për të menaxhuar në mënyrën e duhur rreziqet kibernetike, në çdo hallkë të sistemit të furnizimit. Ky sistem do të sigurohet brenda afatit të përcaktuar nga ERE sipas analizës dhe propozimit të OIKI-së, dhe mund të përfshijë ndër të tjera angazhimin e ekspertëve në fushën e sigurisë së teknologjisë së informacionit si dhe trajnime të ndryshme. Afatet kohore për iniciativat dhe kundërmasat e sigurisë kibernetike do të jenë pjesë e plani të përmirësimit. Prioriteti i masave të sigurisë së rrjeteve për rreziqet e larta duhet të bazohet në raportin e vetëvlerësimit rast pas rasti.

3. Pas paraqitjes së planit të parë të vetëvlerësimit dhe përmirësimit, ERE mund të kryejë monitorime në OIKI dhe në vijim të rezultateve të monitorimit do të paraqesë me rekomandimet përkatëse.

Neni 6

Detyrime të operatorëve të infrastrukturave kritike

1. Për qëllime të kësaj rregulloreje detyrat e operatorëve të infrastrukturave kritike në sektorin energjetik përfshijnë:

a) OIKI-ja duhet të marrë masat teknike dhe organizative për të menaxhuar rreziqet që mund t'i shfaqen e që lidhen me sigurinë e rrjetit dhe të sistemeve të informacionit në të cilat mbështetet shërbimi i licencuar nga ERE, me qëllim sigurimin e vazhdimësisë së shërbimeve objekt licencimi, referuar “Rregullores mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë” (miratuar me urdhër nr. 22, datë 26.4.2018, të AKCESK-së);

b) OIKI-ja duhet të marrë masa për të parandaluar dhe minimizuar ndikimin e incidenteve që ndikojnë në sigurinë e rrjetit dhe sistemeve të informacionit të përdorura për sigurimin e shërbimit për të cilin janë licencuar nga ERE, me qëllim të sigurimit të vazhdimësisë së këtyre shërbimeve. Kategoritë e incidenteve kibernetike përcaktohen sipas “Rregullores për kategoritë e incidenteve kibernetike, si dhe formatin e elementët e raportimit (miratuar me urdhrin nr. 62, datë 10.9.2018, të AKCESK-së);

c) OIKI-ja do të jenë përgjegjëse për zbatimin e masave që garantojnë sigurinë kibernetike nga palët

e treta që ofrojnë shërbime ose produkte të infrastrukturës kritike. Operatorët e rrjetit OST sh.a. dhe OSSH sh.a. do të jenë, gjithashtu, përgjegjës për zbatimin e masave të sigurisë kibernetike nga përdoruesit respektivë të rrjetit;

d) OIKI-ja ka për detyrë për të njoftuar incidentet pranë ERE-s dhe Autoritetit të përcaktuar në përputhje me ligjin nr. 2 /2017 “Për sigurinë kibernetike”. Njoftimi do të kryhet për çdo incident i cili ka një ndikim të rëndësishëm në vazhdimësinë e shërbimit dhe veprimtarisë së licencuar.

2. Në përputhje me përcaktimet e pikës 1, të këtij neni, OIKI, do të raportojë periodikisht një herë në gjashtë muaj, brenda muajit janar dhe korrik për 6-mujorin paraardhës, sipas shtojcës 1, të kësaj rregulloreje, për çështjet që lidhen me zbatimin e germave “a”, “b” dhe “c”, të pikës 1, të këtij neni, dhe në çdo rast tjetër do të njoftojë menjëherë dhe jo më vonë se 4 orë nga momenti i zbulimit të incidentit të sigurisë të identifikuar sipas germës “d”, të pikës 1, të këtij neni.

3. Faktorët kryesorë për vlerësimin e realizimit nga operatori të detyrave sipas kësaj rregulloreje do të monitorohen nga ERE. Në çdo rast, ERE do të vlerësojë:

- nëse janë zbatuar apo jo masa të përshtatshme dhe propocionale të sigurisë kibernetike sipas detyrave që ka OIKI-ja;

- nëse incidentet i janë njoftuar ERE-s.

Frekuenca e ndodhjes së një incidenti sipas germës “d”, pika 1, të nenit 6, në vetvete nuk do të thotë se detyrimisht ka pasur një dështim nga një operator për të përmbushur detyrat e tij të sigurisë.

Brenda 30 ditëve nga ndodhja e një incidenti në infrastrukturat kritike, OIKI-ja duhet të paraqesë një raport të përgjithshëm për ERE-n. Brenda 90 ditëve nga ndodhja e incidentit në infrastrukturat kritike, OIKI-ja duhet të paraqesë në ERE një raport të detajuar të hetimit të incidentit.

ERE, gjithashtu, mund të kërkojë OIKI-së të dorëzojnë pranë ERE-s raporte të audituar në lidhje me hetimin e një incidenti të sigurisë kibernetike.

Neni 6/1

Detyrime të tjera

Operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë veç detyrave të përcaktuara në nenin 6, të kësaj rregullore, do të marrin masa dhe për



zbatimin e përcaktimeve të parashtruara më poshtë në këtë nen:

1. Zbatimin e masave të plota organizative dhe teknike të sigurisë kibernetike në sistemet e komunikimit dhe të informacionit (SKI) nëpërmjet:

a) mbrojtjes së infrastrukturave kritike të informacionit për garantimin e shërbimeve;

b) menaxhimit të aseteve të teknologjisë së komunikimit dhe informacionit;

c) kontrollit të vijueshëm të masave të sigurisë;

d) vlerësimit të vijueshëm të masave të sigurisë;

e) reflektimit të kërkesave të sigurisë në projektet e reja të sistemeve të komunikimit dhe informacionit;

f) zbatimit të teknologjive mbrojtëse;

2. Rritjen e përgjegjësisë së operatorëve të infrastrukturave kritike për sigurinë kibernetike nëpërmjet:

a) hartimit dhe zbatimit të rregullave dhe procedurave të sakta për strukturat përgjegjëse për sigurinë kibernetike në OIKI;

b) hartimit dhe zbatimit të formateve dhe mënyrave të raportimit të sulmeve kibernetike për strukturat përgjegjëse për sigurinë kibernetike në OIKI;

c) zhvillimit të kapaciteteve dhe strukturave të dedikuara për sigurinë kibernetike;

d) koordinimit ndërmjet strukturave për reagimin ndaj sulmeve kibernetike;

e) shkëmbimit të informacionit për sigurinë kibernetike;

3. Zhvillimin e nivelit dhe aftësive të specialistëve të sigurisë kibernetike dhe të përdoruesve të SKI-ve nëpërmjet:

a) rekrutimit dhe caktimit në detyrë të specialistëve për sigurinë kibernetike;

b) trajnimit të vijueshëm të specialistëve, promovimi dhe certifikimi i tyre;

c) konceptimit të trajnimit si një fushë komplekse ku të përfshihet reagimi ndaj incidenteve, testimet penetruuese në sisteme, menaxhimi rrezikut, analizat e kërcënimit, mënyrat paralajmëruese;

d) trajtimit të mbrojtjes kibernetike në programet e trajnimit të stafit përgjegjës të operatorëve të infrastrukturave kritike.

4. Rritjes së bashkëpunimit ndërmjet operatorëve të infrastrukturave kritike në fushën e energjisë elektrike për sa i përket sigurisë kibernetike nëpërmjet:

a) bashkëpunimit në bazë të përcaktimeve të politikës së sigurisë së mbrojtjes kibernetike të Republikës së Shqipërisë;

b) detyrimeve të ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”;

c) pjesëmarrje në trajnime për mbrojtjen kibernetike.

d) shkëmbimit të informacionit të ndërsjellë që lidhet me sigurinë kibernetike ndërmjet OIKI-së.

Neni 7

CSIRT-ja sektoriale

Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin e energjisë elektrike do të përcaktojnë personat përgjegjës për koordinimin, ndjekjen dhe zbatimin e masave për sigurinë kibernetike. Këta përfaqësues do të jenë pjesë e ekipit të përgjigjes ndaj incidenteve të sigurisë kompjuterike (CSIRT-së sektoriale). Përcaktimi i personave përgjegjës për sigurinë kibernetike duhet të bëhet brenda 3 muajve pas hyrjes në fuqi të kësaj rregulloreje. Gjithashtu, operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin e energjisë elektrike do të hartojnë rregullat dhe mënyrën e funksionimit të CSIRT-së sektoriale, duke iu referuar edhe “Udhëzimit për metodologjinë e organizimit dhe funksionimit të CSIRT-eve në nivel kombëtar (neni 7, pika 3, e ligjit nr. 2/2017 “Për sigurinë kibernetike”).

Neni 8

Raportimi

Operatorët e infrastrukturës kritike të informacionit në sektorin e energjisë elektrike do të raportojnë menjëherë dhe jo më vonë se 4 orë nga momenti i zbulimit të incidentit të sigurisë për çdo rast që përbën një shkelje/ndërhyrje, e cila ka cenuar sigurinë kibernetike të infrastrukturave kritike që i licencuari zotëron ose operon, si dhe të çdo shërbimi tjetër që operatori ka në përdorim nga palë të treta.

ERE, me paraqitjen e informacioneve nga të licencuarit në rast të incidenteve të raportuara, do të shqyrtojë rastin e raportuar me të licencuarin për të vlerësuar:

- nëse incidenti ka ndodhur për shkak të veprimeve apo mosveprimeve të operatorit;



- mbi nevojën për rishikimin e akteve rregullatore apo nevojën për mbështetje nga institucionet e tjera ligj zbatuese për veprimet e propozuara me qëllim shmangien, parandalimin apo uljen e numrit të incidenteve.

Në çdo rast ERE mund të kërkojë informacion të detajuar nga OIKI-ja për të mbështetur çdo vlerësim mbi pajtueshmërinë e veprimeve të të licencuarit me rregullat që lidhen me sigurinë e infrastrukturave kritike.

Nëse ERE konkludon se bashkëpunimi me OIKI-në nuk ka funksionuar ose është e qartë se nuk janë marrë masat e duhura për shmangien e incidenteve në infrastrukturat kritike, ERE do të njoftojë operatorin për dështimet e identifikuara. ERE mund të vendosë afate kohore për të korrigjuar dështimet e evidentuara në OIKI.

Neni 9 Penalitetet

Në rast se i licencuari nuk vepron në përputhje me planin e masave, ndaj tij zbatohen sanksione në përputhje me nenin 107, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, si dhe “Rregulloren për procedurat e vendosjes dhe reduktimit të gjobave”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s.

Neni 10 Certifikim me standardin e sigurisë ISO 27001

Operatorët e infrastrukturave kritike në sektorin e energjisë elektrike të pajisen me certifikimin me standardin e sigurisë ISO 27001 brenda 18 muajve nga hyrja në fuqi e kësaj rregulloreje.

Neni 11 Dispozita përfundimtare

Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit dhe publikimit të vendimit të Bordit të ERE në fletoren zyrtare.

SHTOJCË 1

RAPORTI I VETËVLERËSIMIT MBI MBROJTJEN E INFRASTRUKTURAVE KRITIKE DHE MENAXHIMI I RISKUT

Operatori bazuar në “Rregulloren mbi përmbajtjen dhe mënyrën e dokumentimit të masave të sigurisë (miratuar me urdhrin nr. 22, datë 26.4.2018, të AKCESK-së)”, do të raportojë mbi:

Masat organizative, të:

- a) menaxhimit të sigurisë së informacionit,
- b) menaxhimit të rrezikut,
- c) politikave të sigurisë,
- ç) sigurisë organizative,
- d) kërkesave të sigurisë për palët e treta,
- dh) menaxhimit të aseteve,
- e) sigurisë së burimeve njerëzore dhe aksesit të personave,

ë) ngjarjeve të sigurisë dhe menaxhimit të incidenteve të sigurisë kibernetike,

- f) menaxhimit të vazhdimësisë së punës,
- g) kontrollit dhe auditit,

Masat teknike, të:

- a) sigurisë fizike,
- b) mbrojtjes së integritetit të rrjeteve të komunikimit,
- c) verifikimit të identitetit të përdoruesve,
- ç) menaxhimit për autorizimin e aksesit,
- d) veprimtarisë së administratorëve dhe të përdoruesve,
- dh) zbulimit të ngjarjeve të sigurisë kibernetike,
- e) mjeteve të gjurmimit dhe vlerësimit të ngjarjeve të sigurisë kibernetike,
- ë) sigurisë së aplikacioneve,
- f) të pajisjeve kriptografike,
- g) sigurisë së sistemeve industriale.



SHTOJCË 2

Formulari për raportimin e një incidenti të sigurisë dhe/ose cenimit të integritetit	
Informacion kontakti	<i>Emri i sipërmarrësit:</i>
	<i>Emri dhe mbiemri i personit të ngarkuar me eliminimin e incidenteve të sigurisë dhe/ose cenimit të integritetit:</i>
	<i>Pozicioni i punës:</i>
	<i>Adresa:</i>
	<i>Telefon, e-mail:</i>
Përshkrimi i incidentit të sigurisë dhe/ose cenimit të integritetit	<i>Lloji:</i>
	<i>Përcaktimi se cilat rrjete, sisteme ose shërbime preken nga incidenti i sigurisë:</i>
	<i>Koha e ndodhjes dhe kohëzgjatja:</i>
	<i>Informacion rreth shkakut fillestar ose shkaqeve:</i>
	<i>Përshkrimin e incidentit (përcaktoni të dhënat në mënyrë sa më të detajuar):</i>
	<i>Numri i përafërt i përdoruesve të prekur nga incidenti i sigurisë ose cenimi i integritetit ose përqindja e tyre (%) nga përdoruesit total të rrjetit dhe/ose shërbimit:</i>
	<i>Zona gjeografike e prekur nga incidenti i sigurisë dhe/ose cenimi i integritetit (km²):</i>
	<i>Burimet e prekura</i>
	<i>Pasojat:</i>
Menaxhimi i incidentit të sigurisë dhe/ose cenimit të integritetit	<i>Veprimet e ndërmarra (të planifikuara për t'u ndërmarrë) për të eliminuar incidentin e sigurisë dhe për të reduktuar pasojat e tij:</i>
	<i>Masat pas incidentit</i>
Informacione të tjera të rëndësishme	<i>Mësimet e nxjerra</i>
Data	
<i>Formulari depozitohet pranë autoritetit përgjegjës me:</i> <i>E-mail (të skanuara) në adresën: incidente.raportimi@ere.gov.al</i>	



SHTOJCË NR. 3

Raportimi i vetëvlerësimit të operatorit mbi impaktin e incidentit të Sigurisë		
Kohëzgjatja e incidentit të sigurisë (ndërprerjes së shërbimit, interceptimit të komunikimeve, <i>software</i> të dëmshëm, modifikimi i të dhënave)	<i>Më tepër se 1 orë, por më pak se 2 orë</i>	<i>Më tepër se 2 orë</i>
Numri i përdoruesve të prekur nga incidenti ose % e tyre ndaj numrit total të përdoruesve		
→ 5%	<i>Mesatar</i>	<i>i lartë</i>
Në rast të një numri të panjohur të përdoruesve të prekur nga incidenti i sigurisë do të vlerësohet, zona gjeografike e shtrirjes së incidentit të sigurisë		
→ 20 km ²		
Vlerësimi përfundimtar i impaktit:	Mesatar	i lartë

*Shënim: Ky dokument është gjeneruar dhe vulosur me anë
të një procedure automatike nga një sistem elektronik
(Qendra e Botimeve Zyrtare)*

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2020

Adresa: Rr. "Nikolla Jorga", Tiranë
Tel./fax: +355 4 24 27 004 Tel.: +355 4 24 27 006

Çmimi 168 lekë